Informacionet janë paraqitur në shqip dhe anglisht për të gjithë vizitorët e kampit, që duan të informohen për të shkuarën e tij.

Aktiviteti u zhvillua me pjesëmarrjen e kryetarit të Bashkisë Tepelenë, z. Tërmet Peçi, Drejtuesit të Seksionit Politik në BE, z. Alexis Hupin, dhe Ambasadores Amerikane, znj. Yuri Kim.

Të pranishëm në ceremoni, familjarë të të pagjeturve të komunizmit në zonën e Tepelenës, të



ndëshkuarve në kampin e internimit 1949-1953; përfaqësues të Institutit për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë, shoqata të të përndjekurve dhe kujtesës, përfaqësues të institucioneve, Prokuroria, Policia Rajonale, Universiteti i Gjirokastrës, ICMP për Shqipërinë, përfaqësues të komuniteteve fetare të zonës, përfaqësues të grupeve të interesit,

trupit diplomatik, aktorë të shoqërisë civile, gazetarë dhe të rinj.

Që me krijimin e tij në 2017, AIDSSH ka iniciuar dhe mbështetur nisma për përkujtimin e viktimave dhe atyre që u ndëshkuan në kampin me tela me gjemba të Tepelenës, si dhe lëvizje që kanë të bëjnë me muzealizimin, identifikimin dhe gjetjen e të zhdukurve, si dhe kthimin e tij në vend kujtese, të vizitueshëm për të rinjtë e shkollave.

Çdo vit, më 23 gusht, Ditën Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Totalitarizmit, Autoriteti dhe partnerët, me praninë e familjeve dhe trashëgimtarëve të tyre, përkujtojnë njerëzit pa faj që vuajtën në ish-kampin me tela me gjemba në Tepelenë ose humbën jetën atje.



Në këtë kuadër, Autoriteti me Vendimin nr. 54, datë 10.08.2017 ka miratuar realizimin e Projektit të kujtesës “Memoriali Kombëtar i Kampeve të Punës të Detyruar” dhe ngritjen e grupit të punës “Për kërkimin e dokumentacionit arkivor për kampin e Tepelenës dhe krijimin e një memoriali për përkujtimin e datës 30 gusht, si Dita Ndërkombëtare e të Zhdukurve”, bazuar në ligjin nr. 45/2015 dhe

ligjin nr. 9154, dt. 06.11.2003 “Për arkivat”, mbi përgatitjen dhe hapjen e ekspozitave dokumentare. Po ashtu, në zbatim të ligjit nr. 9802, datë 13.9.2007 “Për Ratifikimin e

Konventës Ndërkombëtare të OKB-së “Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë”.

Ky projekt përmban rikthimin në identitet, si kamp dëbimi të një prej kapanoneve, vendosjen e stendave me dëshmi (fotografi dhe dëshmi arkivore) për kampet e dëbim – internimit, dizenjimin, pozicionimin si dhe mbjelljen e disa fidanëve (qiparisa) për përkujtimin e fëmijëve që kanë humbur jetën nga kushtet e vështira në Kampin e Tepelenës dhe janë pa vendvarrim. Ndërtimi i këtij Memoriali shënon vetëm hapin e parë për transformimin e të gjithë kompleksit në një Muze të Kampeve të Punës së Detyruar të Diktaturës Komuniste.

Projekti është miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Tepelenë nr. 40, datë 30.11.2017 “Për miratimin e objekteve prioritare të investimeve për vitin 2018”, konfirmuar në datë 14.12.2017 nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

Në vijim, Autoriteti ka firmosur disa marrëveshje bashkëpunimi me partnerë, të cilët ndihmojnë në mbledhjen e dokumenteve dhe të dhënave zyrtare si dhe në ndërgjegjësimin qytetar dhe edukimin shoqëror, duke e rishqyrtuar historinë dhe rivlerësuar atë. Për mbledhjen e dokumenteve zyrtare mbi Kampin e Tepelenës është bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, me Institutin e Integritit të Përndjekurve Politikë, Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri. Në këtë kuadër, projekti është mbështetur nga Bashkia e Tepelenës dhe partnerë të AIDSSH, si PNUD, OSBE e institucione të tjera, publike, akademike dhe të kërkimit shkencor. Me Muzeun Kombëtar të Kampeve të Punës në Tepelenë, AIDSSH synon të krijojë një model për të gjitha kampet e punës së detyruar në Shqipëri, ku e shkuara të shërbejë për reflektim e të mos përsëritet.



Marrëveshja në zanafillë me PNUD-in, (2018) i dha jetë programit “Përkujtojmë, për të shëruar dhe parandaluar” me dy ndërhyrje kryesore: (i) konceptualizimin, historinë, dhe praktikën e punës së detyruar gjatë regjimit komunist përmes një qasjeje historiko – juridike ndaj institucionalizimit të punës së detyruar, për konceptimin e vendeve të kujtesës si Kampi i Tepelenës dhe (ii) fushatën e komunikimit “Edhe muret kanë veshë” zbatuar nga Autoriteti, me mbështetjen e PNUD Shqipëri dhe Qeverisë së Italisë. Fushata u shtri në mbarë vendin, duke mbledhur dëshmi të të mbijetuarve të dënuar gjatë periudhës komuniste dhe dëshmi të solidaritetit që qytetarët e Tepelenës treguan ndaj viktimave.

Projekti “Edhe muret kanë veshë” u zbatua përgjatë vitit 2018 në të gjithë Shqipërinë, në disa përmasa: mbledhja e dëshmive gojore, instalacioni artistik, libri dhe platforma e dëshmive gojore në gjuhën shqipe e angleze, për t’u finalizuar me filmin që e dokumenton këtë proces, duke hedhur dritë në hapat e ndjekur për zbardhjen e së shkuarës.

Në mjediset e ish-kampit të internimit në Tepelenë, Autoriteti, në bashkëpunim me Bashkinë e Tepelenës, MEMO, të mbijetuar, institucione dhe shoqëri civile aktive, me mbështetjen e PNUD Shqipëri, Qeverisë së Italisë, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe



OSBE, organizoi Ditën Muze/Memorial Tepelenë, më 23 gusht, në Ditën Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare.

Ekspozita “Persekutimi komunist në zonën e Tepelenës” mbledhi komunitetin vendas dhe të mbijetuar, familjarë e pasardhës të tyre nga e gjithë Shqipëria, në Pallatin e Kulturës të qytetit të Tepelenës, dhe u krijoi mundësinë të

njihnin punën e Sigurimit të Shtetit në këtë zonë, duke u paraqitur materiale voluminoze, ekspozuar objekte muzeale dhe plotësuar formularë për njohje me dosje individuale.

Simpoziumi shkencor për kuadrin historik e juridik të punës së detyruar në diktaturë u moderua nga z. Marenglen Kasmi, anëtar i Autoritetit, dhe kumtesat u mbajtën nga znj. Sonila Boçi, Instituti i Historisë, në emër të prof. Beqir Meta; znj. Ermira Shtino, në emër të prof. Ermal Frashëri dhe z. Çelo Hoxha i ISKK. Puna e detyruar në diktaturë u paraqit në disa aspekte nga studiuesit dhe u trajtua gjerësisht në konferencën shkencore të fundtëtorit “Të mohuarit e regjimit”, mbi internim-dëbimet në vend.

Para mbi 200 të pranishmëve, të mbijetuar e trashëgimtarë të tyre, të ardhur nga gjithë vendi me autobusë të posaçëm, mbështetur nga Bashkia Shkodër, zonja Voltana Ademi; nga Elbasani, mbështetur nga zoti Fatbardh Doko dhe Tirana, mbështetur nga IIPP dhe OSBE; para qytetarëve të Tepelenës, historianëve, studentëve dhe medias, arkitekti Gjon Radovani bëri një paraqitje të ecurisë së punës për ngritjen e Muzeut Kombëtar të Punës së Detyruar në Tepelenë. Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, në prani të të mbijetuarve e familjarëve të tyre, përfaqësuesve të institucioneve publike e lokale, shoqatave të të drejtave të njeriut, përfaqësuesve të të gjithë spektrit politik, organizatave ndërkombëtare dhe të rinjve të pranishëm, dekoroi në Kampin e Tepelenës për “Merita të Veçanta Civile”, të mbijetuarit: Znj. Gjelë Gjikota dhe znj. Mrikë Gjikota (Age Totaj, e bija tërhoqi titullin); znj. Drane Jakja (pas vdekjes), (Nikë Vuksani, i biri tërhoqi titullin) dhe z. Lek Pervizi, që ka sjellë dëshmi të gjalla deri në të sotmen, duke përdorur thëngjill e laps për të dokumentuar me saktësi akribike figura, ndërtesa, situata, portrete dhe njerëz, pa i interpretuar, me qartësinë dhe besnikërinë e një fotografie.

Përballën qëndrimet e tyre në ceremoni znj. Gentiana Sula, kryetare e Autoritetit; z. Simon Mirakaj, anëtar i Autoritetit, i internuar në Tepelenë; znj. Mirela Kumbaro, Ministre e Kulturës; z. Brian Ėilliams, përfaqësues i PNUD në Shqipëri; znj. Voltana Ademi, kryetare e Bashkisë Shkodër; z. Nebil Çika dhe z. Bilal Kola, drejtues të shoqatave dhe Institutit të ish-të



Përndjekurve Politikë. Edhe shoqata “Vatra” në SHBA paraqiti një deklaratë në mbështetje të muzealizimit të kampit, e lexuar nga Simon Mirakaj.

Në mbyllje të ceremonisë, Presidenti i Republikës u shpreh se “pajtimi mund të arrihet duke kërkuar të falur, duke pranuar përgjegjësitë, duke shprehur respekt për të gjitha viktimat e

regjimit totalitar dhe duke respektuar ata që luftuan kundër tiranisë dhe shtypjes. Drejtësia për viktimat e regjimit komunist dhe totalitarist është thelbësore. Kërkimi i së vërtetës, hapja e arkivave, procedurat e lustracionit, rehabilitimi, integrimi dhe dëmshpërblimi i tyre janë disa nga mënyrat për t'u shprehur atyre dhe familjarëve të tyre mirëkuptimin, simpatinë dhe njohjen e vuajtjeve të tyre.”

Nderimi i të mbijetuarve dhe sakrificës së tyre u parapri nga aktivitete të ndryshme në kamp, që të rinjtë dhe të pranishmit të njihnin e të vlerësonin përmes kujtimeve, dramën njerëzore të mijëra familjeve, të jetuar ditë pas dite.

Projektet Sikur Mama... që i shoqëruan të ftuarit 2 kilometra pa arritur në kamp me kamion deri në hyrje të tij, me një këngë të kënduar nga Mariza Ikonimi, e ardhur nga dëshmia e Klora Merlikës, e mbijetuar; Shtrati-dhomë, që rindërtoi strukturën e drunjtë në të cilën jetonte dhe flinte një familje e tërë sipas dëshmive, dhe I përkasim njëri-tjetrit, që rrëfen në vetë të parë histori të mbijetesës në Tepelenë, synuan që përmes ndërveprimit t'i njihnin të pranishmit me kampin dhe të nxisnin reflektim. Projektet u ndërmorën dhe mbështetën nga MEMO.

Në të njëjtën kohë, qytetarë të shumtë në kamp e jashtë tij blenë dhjetëra qiparisë (82) për Memorialin e fëmijëve që nuk i mbijetuan Tepelenës, hapi i parë për ngritjen e Muzeut Kombëtar të Kampeve të Punës së Detyruar.

Veç të tjerash, projekti ICMP-AIDSSH: **“Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit të komunizëm”**, 2020-2022, mbështeti punën kërkimore të disa shoqatave dhe organizatave të shoqërisë civile, për identifikimin e fëmijëve që humbën jetën në kampin e Tepelenës dhe për zbardhjen e historisë së zonës, nëpërmjet dokumenteve dhe dëshmive të të mbijetuarve, dokumentarëve të përgatitur për këtë qëllim dhe të shpërndarë masivisht.

**PËRUIROHET EKSPOZITA E JASHTME E PËRHERSHME
NË ISH-KAMPIN E MALIQIT**

Maliq, 17 shkurt 2022– Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, në bashkëpunim me Bashkinë dhe Këshillin Bashkiak të Maliqit, në mbyllje të projektit ICMP-AIDSSH “Rritja e



ndërgjegjësimi të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimin: të zhdukurit të komunizëm”, të mbështetur nga BE dhe Ambasada

Zvicerane, përuruar ekspozitën e përherëshme informuese mbi ish-kampin e punës në Maliq.

Ekspozita e jashtme e përherëshme informuese është përgatitur mbi hulumtimin e të dhënave arkivore mbi të dënuarit në kampin e punës të Orman-Pojanit, Vloçishtit. Informacionet janë paraqitur në shqip dhe anglisht për të gjithë ata që duan të njihen me historinë e zonës dhe të informohen për të shkuarën e tij.

Këshilli Bashkiak Maliq, në mbledhjen e datës 4 shkurt, miratoi kthimin në vend ndërgjegjësimi të kthesës së Pocestës në Vloçisht dhe vendosjen e pllakateve përkujtimore në të, propozim i hershëm i AIDSSH, i mbështetur nga shoqatat e të përndjekurve në zonë.

Aktiviteti u zhvillua fillimisht në Bashkinë Maliq, me pjesëmarrjen e Kryetarit të Bashkisë, z. Gëzim Topçiu, Kryetarit të Këshillit Bashkiak, z. Ornildi Demollari, mbesës së inxhinier Kujtim Beqirit, znj. Liliana Çoçoli, Drejtueses së Seksionit të Qeverisjes dhe të Drejtave në Njeriut në BE, z. Lenka Vitkova, dhe drejtueses së Këshillit të Europës në Shqipëri, znj. Jutta Gitzkoë.

■ **Znj. Gentiana Sula**, Kryetare e Autoritetit, theksoi rëndësinë e vendosjes së memorialit mbi kampin e Maliqit për informimin e brezave dhe të rinjve. Përrurimi i tij është një nismë e finalizuar e Autoritetit, e nisur që në 2019, me kërkesën e bërë Bashkisë Maliq.

■ **Z. Gezim Topçiu**, Kryetar i Bashkisë Maliq nënvizoi rëndësinë e kësaj dite për kthimin në vend ndërgjegjësimi të kthesës së Pocestës dhe bërjen të vizitueshëm për të rinjtë e të interesuarit. Ai shprehu gatishmërinë për bashkëpunimin me Autoritetin dhe institucionet e tjera për hapësirën e Muzeut Maliq.



■ **Z. Ornildi Demollari**, Kryetar i Këshillit Bashkiak Maliq foli mbi vendimin e këshillit, duke nderuar të gjithë ata që vuajtën apo humbën jetën në Maliq.

■ **Znj. Liliana Çoçoli**, mbesa e inxhinier Kujtim Beqirit, i cili u dënua me varje si “sabotues” i tharjes së kënetës së Maliqit, e cila përfundoi më shumë se një dekadë më pas, solli zërin e familjeve, të cilat, të dënuara e ndëshkuara në vite si “armike të popullit”, vuajtën stigmën gjatë komunizmit. Personalitete të nderuara në botë e në Shqipëri, me vepra të cilat ende sot janë vlerë e infrastrukturës publike, ata u dënuan pa faj, me gjyqe publike, për faje të stisura. Mbi “sabotimin” e tyre u ngritën ngrehina të propagandës, filma e romane, që shtrembëruan të vërtetën dhe ende u dhembnin familjarëve të parehabilituar.

■ **Znj. Lenka Vitkova**, Drejtuese e Seksionit të Qeverisjes dhe të Drejtave në Njeriut në BE, foli në emër të projektit të përbashkët AIDSSH-ICMP, produkte të të cilit ishin edhe pllakatet e vendosura në Tepelenë dhe Maliq. Znj. Vitkova theksoi vlerën e përkujtimit dhe punën për të zhdukurit, si mbështetje e BE-së për Autoritetin dhe institucionet.

■ **Z. Simon Mirakaj**, anëtar i Autoritetit, citoi një sonet të Uran Kostrecit mbi kënetën e Maliqit dhe vlerësoi organizime të tilla, ku institucionet dhe familjarët bëhen bashkë për të nderuar të dënuarit pa faj në komunizëm.

■ **Z. Ylber Merdani**, Kryetar i shoqatës së të përndjekurve politike në Korcë shprehu kënaqësinë për një dëshirë të realizuar, kërkesë e hershme e tyre, që u mundëson familjarëve të ndezin një qiri për të dashurit e tyre pa varr.

Më pas, aktiviteti u zhvendos në kthesën e Pocestës, në Vloçisht, për zbulimin e pllakateve dhe ceremoninë e përrurimit.

Kampi i Orman Pojanit u mbiquajt “kampi i vdekjes”. Mijëra jetë njerëzore punuan për tharjen e kënetës, mes të cilëve shumë intelektualë, si, Mitrush Kuteli, Jusuf Vrioni, Arshi Pipa, Sami Repishti, Halit Selfo, Vexhi Buharaja, Pashko Gjeçi, Sulejman Vuçitërna, Hafiz Ali Kraja, Atë Josif Papamihali, sot martir, etj.

Të pranishëm në ceremoni ishin familjarë të të pagjeturve të komunizmit në zonën e Maliqit, të ndëshkuarve në kampin me punë të detyruar; përfaqësues të Institutit për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë, shoqata të të përndjekurve dhe kujtesës, përfaqësues të institucioneve, Prokuroria, Policia Rajonale, Universiteti i Korçës, ICMP për Shqipërinë, përfaqësues të komuniteteve fetare të zonës, përfaqësues të grupeve të interesit, trupit diplomatik, aktorë të shoqërisë civile, gazetarë dhe të rinj.



Në takim u shpërndanë kopje të botimit të AIDSSH “E vërteta e inxhinierëve të kënetës së Maliqit”, ku zbardhen materialet e Sigurimit mbi grupin e dënuar dhe stigmatizuar si “sabotator”, në vitin 1946. Libri u prezantua në shtator 2021, në Bashkinë Maliq, kur edhe u premtua vendosja e pllakateve përkujtimore nga kryetari i Bashkisë, z. Topçiu.

Sfida për kthimin e zonës në vend kujtese, të vizitueshme nga të rinjtë e shkollave mbetet e hapur.



Prezantohet libri me dëshmi të familjarëve të të zhdukurve në diktaturë dhe ekspozita virtuale “Sigurimi në fjalët e veta”

Ceremonia përmbyllëse e projektit ICMP-AIDSSH për rritjen e ndërgjegjësimit për të zhdukurit gjatë regjimit komunist

Tiranë, 24 shkurt 2022 - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të



Shtetit prezantoi librin me dëshmi për të zhdukurit dhe ekspozitën virtuale “Sigurimi në fjalët e veta”, në mjediset e reja, pranë garnizonit Skënderbej, Rruga e Dibrës.

➡ Ceremonia përmbylli projektin ICMP-AIDSSH “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit:

të zhdukurit të komunizëm”, të mbështetur nga BE dhe Ambasada Zvicerane.

Të gjitha produktet e rëndësishme të këtij projekti që e ndikoi ndjeshëm debatin shoqëror mbi të zhdukurit në komunizëm u prezantuan në aktivitet, në gjuhën shqipe dhe angleze.

Të pranishëm në ceremoni, familjarë të të pagjeturve të komunizmit; përfaqësues të shoqatave të të përndjekurve dhe kujtesës, përfaqësues të institucioneve, ICMP për Shqipërinë, të grupeve të interesit, trupit diplomatik, aktorë të shoqërisë civile, gazetarë dhe të rinj.

Gjatë aktivitetit u bë një paraqitje e punës së Autoritetit, ICMP dhe partnerëve në të gjithë vendin, për rritjen e ndërgjegjësimit për çështjen e të zhdukurve në diktaturë, qartësimin e fatit të tyre, për ruajtjen e vendvarrimeve dhe më tej, kthimin në vende kujtese.

■ **Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula**, foli për rëndësinë e trajtimit të rasteve të



të pagjeturve dhe standardin që duhet të përmbushë shoqëria sot. Duke cituar Solzhenicinin, sipas të cilit: “Bota, njerëzimi, nuk mund të ekzistojë përballë dy sistemeve të vlerave, sepse ne do të copëzoheshim nga kjo pabarazi ritmi, kjo pabarazi vibrimesh. Ashtu si një njeri me dy zemra nuk është për këtë botë, as ne nuk do të

mund të jetonim kështu krah për krah, në një tokë,” Kryetarja Sula këmbënguli që t’i njohim e të trajtojmë të drejtat e mohuara të pagjeturve dhe të familjarëve të tyre sot, duke u distancuar nga indoktrinimi, stigma e luftës së klasave dhe ideologjia, me zemër të hapur dhe pa nënvlerësuar asnjë rast.

■ **Z. Luigj Ndou, përfaqësues i ICMP për Shqipërinë**, tha se “rrëfimet tragjike të përshkruara në këtë libër janë reflektim i ngjarjeve tragjike që do të mbeten për një kohë të gjatë në kujtesën e këtij vendi. Ky reflektim nuk bëhet për ata që kanë ikur në mënyrë të padrejtë, në mënyrë arbitrare dhe çnjerëzore, por për brezat që do të vijnë, përndryshe, nuk mund të kemi një shoqëri demokratike që synon t’i bashkohet familjes europiane dhe të adaptojë vlerat e saj, me groposjen dhe harresën e së kaluarës.”

“Ne do të vazhdojmë të ndihmojmë autoritetet shqiptare, por mendojmë se koha për të vepruar është tani, sepse infrastruktura ligjore është krijuar. Familjarët e këtyre personave nuk po kërkojnë lëmoshë nga institucionet, ata kërkojnë të drejtën e patjetërsueshme për t’u kthyer dinjitetin e humbur të të dashurve. Shpresoj që ky të jetë fillimi i shndërrimeve konkrete dhe Shqipëria të avancojë për t’i dhënë zgjidhje çështjes së personave që u zhdukën padrejtësisht gjatë regjimit komunist.”

■ **Znj. Frederique Hanotier, përfaqësuese e Bashkimit European në Shqipëri,** e vuri theksin në këtë raport e pabalancuar të shoqërisë me viktimat e së shkuarën komuniste. Ajo nënvizoi rëndësinë e këtij projekti mbresëlënës që u shtri në të gjithë vendin dhe arriti në të gjitha



nivelet të trajtojë çështjen e të zhdukurve në diktaturë, duke e kthyer në çështje të ditës. Po ashtu, znj. Hanotier siguroi mbështetjen e BE-së për kauzën, duke kërkuar që institucionet të kryejnë detyrën e tyre.

■ **Z. Skënder Vrioni, Sekretar i Përgjithshëm i Autoritetit,** foli për rezistencën në hapat e hedhur për të qartësuar fatin e të zhdukurit, për arsye të mosbesimit, kohës së gjatë pas rënies së komunizmit, apatisë së institucioneve, mungesës së koordinimit dhe protokolleve të mirëpërcaktuara. “E gjitha është dashur të përballet me punë serioze, takime me ekspertë, konsultime publike me palët dhe institucionet, për të finalizuar një produkt serioz.”

Sipas z. Vrioni, “sot kemi në dorë udhërrëfyesin për të drejtat e familjarëve të të zhdukurve, si bashkëpunim yni me ICMP, për të gjithë familjarët që duan të dinë cila është rruga ligjore për t’i kërkuar të dashurit e tyre, në shqip dhe anglisht, edhe për trashëgimtarët e atyre që u larguan nga vendi.

Po ashtu, kemi punuar fort për marrëveshje me Policinë e Shtetit, e cila u nënshkrua në fillim të shkurtit dhe me draft VKM që koordinon punën për të zhdukurit, me të gjitha protokollet standarde, që aplikohen sot nga praktikantët më të mira botërore.

Ekspertë shumë të mirë të fushës kanë bashkëpunuar me Autoritetin për ta sjellë VKM që përcakton ligji 45/2015 i ndryshuar, sa më të plotë, pasi është konsultuar gjerësisht me palët dhe institucionet.

Sfida e radhës është t’i drejtohem terrenit, aty ku janë vendet e dyshuara si vendvarrime të personave të zhdukur. Kjo është detyra jonë, e të gjitha institucioneve përgjegjëse, e partnerëve tanë vendas dhe ndërkombëtarë, e atyre që na mbështesin.

■ **Znj. Fatmira Nikolli**

, gazetarja që bashkëpunoi me Autoritetin për finalizimin e ekspozitës “Sigurimi në fjalët e veta” u shpreh se “ekspozita u rrek të sillte në mënyrë të thjeshtë historitë e 45 vjetëve, histori që vazhdojnë të mohohen edhe sot nga ata që patën fatin të mos ishin të dënuar.

Problemi i shoqërisë shqiptare është që ne mohojmë ato që s’kanë qenë fati ynë. Nëse një pjesë e shoqërisë shqiptare ka qenë në burgje, nëse një pjesë e shoqërisë shqiptare ka qenë e dënuar, nëse një pjesë e shoqërisë shqiptare ende nuk e di se ku i ka varret e të afërmve, arsyeja se pse ne nuk i zbardhim ende është sepse pjesa tjetër e mohon. E ka mohuar për 45 vjet e vazhdon ta mohojë edhe sot.

Nuk mund të bëhet ende drejtësi, nuk mund ta zbulojmë të shkuarën dhe as mund të gjejmë varret e atyre që janë zhdukur, për aq kohë sa nuk pranojmë se ajo që ka ndodhur është krim e vazhdon të mbetet krim edhe sot.”

■ Sipas **z. Marcel Hila**, ekspert që punoi me dëshmitë e familjarëve të të pagjeturve, “ajo që më ka bërë përshtypje nga dëshmitë është dhimbja e pafund që ata kanë përjetuar, ndaj është një mision i vyer për shoqërinë zbulimi i vendvarrimeve të atyre që u vranë dhe humbën jetën, trupat e të cilëve nuk iu dorëzuan kurrë familjes. Po ashtu, ngritja e strukturave përkatëse për ta ndjekur këtë punë në çdo fazë.”

■ **Dr. Mirela Sinani**

, ekspertja që punoi me librin e dëshmimeve, përvojë në vijim të dëshmimeve të para të mbledhura, ato të kampit të Tepelenës, bëri një paraqitje të punës së saj me intervistat dhe të vërtetat ulëritëse të dhimbjes njerëzore, të shprehura nga familjarët e të zhdukurve.

Sipas Dr. Sinani, “shoqëria e sotme është e turpëruar dhe duhet të mbajë kokën ulur për mënyrën si janë trajtuar njerëzit me mendim të lirë, me mendim ndryshe, të cilët, edhe pas 30 viteve, jo vetëm që nuk janë gjetur e vendosur në varret familjare, por nuk janë rehabilituar, siç është detyrim i shoqërisë sot”.

Ceremonia u moderua nga **Ardita Repishti**, e cila e mbylli me fjalët e Atë Pjetër Mëshkallës: “Për me kalue nëpër ujë hidhen gurë të mëdhenj e të vegjël, të parët, të dytët, të tretët...zhduken, zhyten, nuk shihen ma.... hidh e hidh, tek e fundit nisin me nxjerrë krye disa aty-këtu; rrëshqasin, prapë hidhen të tjerë...deri sa bahet kalimi, keq a mirë, por bahet.

Ka me ardhë koha që do të bahet ma mirë. Na jemi gurët, të mëdhenj e të vegjël, të hedhun në fillim, të cilët zhduken e nuk shihen ma, por janë në themel të parë...

Ky është synimi i themelit: Me u zhdukë e mos me u pa ma! Prej të parëve pritëm një Shqipni të lirë! Nipat presin prej nesh një Shqipni të lumtun!”

Projekti që synoi rritjen e ndërgjegjësimit mbi personat ende të pagjetur, të dënuar nga regjimi komunist, u shtri për mbi një vit në të gjithë vendin.

Udhërrëfyesi për familjarët e të zhdukurve të komunizmit, në shqip dhe anglisht, u finalizua në konsultim publik dhe me grupet e interesit.

U zhvilluan takime dhe vizita në terren në Shkodër, Malësi të Madhe, Porto-Palermo, Himarë, Shën-Vasil, Sarandë, Tepelenë, Gjirokastrë, Korçë e Maliq, ku u prezantua udhërrëfyesi dhe u mblodhën dëshmi mbi të pagjeturit.

Ekspozita “Sigurimi në fjalët e veta”, me 19 historikë të Sigurimit, ku policia sekrete e regjimit merr autorësi për krime e veprime të dhunshme, u prezantua më 30 gusht 2021, Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve, në Kryeministri, me materiale të deklasifikuara për qëllime studimore.

Broshura voluminoze “Zhdukur”, me të gjitha materialet e ekspozitës, është një ndër botimet më të shpërndara të Autoritetit.

Sot ekspozita mund të vizitohet virtualisht, në dy gjuhë, në çdo kohë.

Libri “Të zhdukur në diktaturë, dëshmojnë familjarët”, me dhjetëra dëshmi të familjarëve, nga veriu në jug, nga lindja në perëndim, brenda dhe jashtë vendit, përmbledh historitë e shumta të familjeve që bashkëjetuan për vite me traumën e humbjes, të padijes dhe të përndjekjes. Historitë janë apel institucioneve për veprime konkrete. Disa prej të intervistuarve u ndanë nga jeta pasi dhanë dëshminë e tyre për Autoritetin.

Dy ekspozita të përhershme informuese në shqip dhe anglisht u vendosën në ish-kampin e internimit në Tepelenë dhe në ish-kampin e Maliqit, të parët memorialë që nderojnë vuajtjen e të pafajshmëve në zonë.

Të gjitha takimet u zhvilluan me praninë e drejtuesve të pushtetit lokal, Prokurorisë e Policisë rajonale, universiteteve të zonës, familjarëve të të pagjeturve të komunizmit; shoqatave të të përndjekurve dhe kujtesës, komuniteteve fetare.

Gjatë projektit, u bashkëpunua me institucionet përgjegjëse për koordinimin e



protokolleve për qartësimin e fatit të të zhdukurit, në mbështetje të ligjit 45/2015, në disa tryeza të rrumbullakëta, të koordinuara nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe u nënshkrua marrëveshja mbi të zhdukurit në diktaturë, mes Autoritetit dhe Policisë së Shtetit.

NJOHJA NXIT STUDIMIN

Konceptet: disidencë, disident në kuadër më të gjerë teorik

📖👉 *Studimi me titull: Konceptet: disidencë, disident në kuadër më të gjerë teorik u përgatit nga Edona Jahiu, Ph.D. candidate në Universitetin e Prishtinës, në kuadër të konferencës ndërkombëtare shkencore të AIDSSH me ASA, ISKPK, IIPP, “Fytyra e “Armikut” të popullit”.*

Gjatë një periudhe presioni, siç ka qenë komunizmi te shqiptarët, kur nocioni i së vërtetës nuk është vënë në diskutim dhe kur ishin të imponuara rreptësisht disa ideologji të caktuara, ka qenë jashtëzakonisht e vështirë të bëhej rezistencë a orvatje për mosnënshtrim, e rrjedhimisht, të dëgjohej ndonjë zë apo reagim kritik ndaj pushtetit të dhunshëm.

Në Shqipëri, edhe pse ka ndonjë gjurmë në raste sporadike apo “mes rreshtash” nga disa intelektualë, kryesisht, populli i është bindur padiskutueshëm shtetit, ka heshtur, dhe


ekzistojnë dilema nëse ka pasur ndonjëherë disidencë të mirëfilltë qoftë në letërsi, kulturë apo në plan më të gjerë. E, në këtë punim, fillimisht duke e sqaruar komunizmin e realizmin socialist,

synojmë që të fokusohemi më shumë në shpjegimin teorik të nocioneve: disidencë, disident,

duke e ilustruar me disa raste më tipike dhe efektive që kanë dalë në sipërfaqe në sisteme totalitare nëpër botë.

Kështu, me mbështetje teorike dhe praktike me shembuj të zgjedhur e me disa ndërhyrje interpretuese individuale, kemi për qëllim ta përshkruajmë dhe analizojmë sa më qartë disidencën, si një lëvizje refuzuese ndaj autoritetit nga një ose disa individë, që, edhe pse bart rreziqe, mbetet me vlerë e impakt dhe vulozet në historinë e një populli, sepse guximshëm vë në

pikëpyetje elitën politike dominuese, e cila e “vret” demokracinë.



KONFERENCË NDËRKOMBËTARE SHKENCORE

Flutura Aça - "Uran Kostreci: Heroi i Epopesë së Humanizmit"

📖 Në një qytet të mbytur nga pluhuri i Metalurgjikut, të rrëqethur me vite nga sirenat e ambulancave që bartnin për në spitale qindra djem e vajza të vranë e djegur nga teknologjia e vjetër kineze e kovaçanës komuniste, të cilën diktatura e identifikoi me çlirimin e dytë të Shqipërisë, një qytet, ku historinë e lavdishme të edukimit të shekujve e kishin mbytur koret e fëmijëve nën Furnaltë, një qytet, ndoshta i vetmi në botë, që kishte një rrugë me emrin “Rruga e mundimeve”, duke nënkuptuar institucionet e diktaturës të instaluar përgjatë saj, ruhej i fshehur diku si stoli edhe një oborr të vogël me lulet më të bukura që ky qytet mban mend e për në bri tyre jetonte një burrë, i cili kishte kaluar dekada në burg.

👉 Ai ishte Uran Kostreci.

Ishte fundi i viteve 80-të kur kjo ngastër e vogël u bë simbol i ngjyrës, por edhe i lirisë në Elbasan dhe pati vizitorë të shumtë asokohe, kështu që historia magjepsëse e burrit të bri trëndafilëve, qarkulloi gjatë nën hijet e portokallëve të oborreve elbasanas.

Uran Kostrecin e njoha një ditë pranvere të vitit 1992 në shkallët e redaksisë së gazetës “Fjala e lirë”, ndër të parat e pavarura të asaj kohe, ku prej 1 shkurtit isha gazetarë. Njiheshim prej poezive të botura në po të njëjtat rubrika. Nuk foli për burgun atë ditë, e thoshte portreti i tij ku ishte gdhendur asketizmi. Nuk i ndjeva urrejtje, foli për sonetet dhe më recitoi një duzinë syresh në rrugë, ndërsa shkonin te një bar aty pranë. Honoraret e tij të vogla nuk mbërritën kurrë në apartamentin e tij. Sapo e merrte honorarin e gazetës për shkrimet politike apo poezitë e botuara, e zhyste në xhep dhe na ftonte përherë neve miqtë e tij për të festuar në restorantet modeste të Elbasanit të asaj kohe.

Një ditë më ftoi për drekë në apartamentin e tij, që nuk mund të ishte veçse një zgjatim asketik i atyre qelive të dikurshme. Po kishte kaq ajrë në qenien e tij, përmasë që i vinte nga liria, sa këto mungesa materiale ishin të papërfillshme.

Dhoma ku hymë kishte një shtrat thujse mbërdhes, një tryezë që mezi mbahej dhe dy karrige, dhe letra gjithandej: sonetet e tij dhe shënimet e “Epopesë së Karkalecëve”. Urani derdhi në dy

FLUTURA AÇA: "URAN KOSTRECI HEROI I EPOPESË SË HUMANIZMIT"



pjata supën e tij të hollë të orizit dhe ne e mirosëm drekën tonë modeste me recitime poezish, siç bënim përherë.

Zakonisht minutat tona poetike në bare a restorante nuk i përziante me punët e shumta të partisë, sepse, ja, pak minuta më vonë, dikush do të vinte, do t'i fliste te supi zëulët dhe ai do të ngrihej për ta zgjidhur atë kleçkë politike, duke ikur me nxitimin që i shfaqej te kindat e hapura të xhaketës a pardesysë modeste tek tretej tutje.

Me të njëjtin portret të skalitur, me borsalinon e përjetshme, me hundën e hequr dhe mollëzat e vogla me një të purpurt të lehtë, aq sa të ngjyente zbehtësinë dhe dobësinë e tij epike, Uran Kostreci ishte një qenie nga një botë puritane a nga shekuj më idealistë për racën njerëzore. Ca kohë më vonë, na thirri një ditë befas të përshëndeteshim pasi do të ikte në Amerikë. U ndamë me lot dhe për heroin tim të humanizmit dëgjoja vetëm kur vinin lajme përtej Atlantikut. Vite më vonë, nga fate që nuk i dimë se ku shkruhen, ne filluam të shiheshim çdo ditë te bar Piazza. Një tryezë në cep aty ishte studioja e tij ku shkruante sonetet dhe konsumonte menynë e tij strikte: dy vezë të padëmuara nga skuqja, dhe bukë.

Ndonjëherë ulesha në tryezën e tij dhe flisnim edhe për politikën. I bërë def prej saj, përpiquej të mos e shfrente mërzinë dhe kujdesej t'i përmirësonte minutat tona në tryezë me veshtullinë lirike të një soneti që sapo kishte shkruar. Disa prej tyre ishin vërtet të thukëta politike.

Lajmin për ikjen e tij e mësova jashtë vendit dhe kur u ktheva nuk e pata të lehtë për ditë e javë të pranoja që në cepin e tij në bar nuk do të shfaqej më burri galant, i cili ngrihej e të puthte dorën kur e takojë.

Njeriu i rezistencave të mëdha të dëshmuara nga miqtë me të cilët ndau fatin tragjik qelive të komunizmit, rrëfyesi i patëdytë i të vërtetave të Gulakut shqiptar, edhe vetë një dëshmi që ecte, nuk bërtiti kurrë, nuk u ankua kurrë, nuk kërkoi kurrë. Shumë pezme që i shkaktoi demokracia defektoze shqiptare, i përbiu në vete, me të vetmen qetësi, se nuk ka asgjë më të tmerrshme se komunizmi.

Ndaj, një antikomunist si Uran Kostreci, zor ka lindur apo do të lindë kjo tokë.

Ashtu e kujtoj ende heroin tim të epopesë së humanizmit, tek ecën, më tërheq krahun e më thotë: "Komunizmi edhe bakllava të ishte, do ta pështyja".

**U kujtofte përherë me dritë dhe mirënjohje, poeti, politikani dhe humanisti
Uran Kostreci!**

Botimi “E vërteta e inxhinierëve të kënetës së Maliqit”, i punuar nga historianë dhe me dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, hedh dritë në materiale arkivore më herët sekrete, të shfrytëzuara mbi historinë e shtrembëruar në vite nga politika dhe propaganda.

👉 Kënetat e Maliqit zinte një sipërfaqe shumë të madhe toke dhe ishte bërë burim sëmundjesh malarike për zonën. Plani për tharjen e saj ishte hartuar në vitin 1936, nga inxhinieri italian Angelo Omodeo, në përfundim të të cilit parashikoheshin të thaheshin 4500 ha tokë dhe të bonifikoheshin 4500 të tjera.

Në fillim të vitit 1946, Ministria e Punëve Botore, e bazuar në projektin e Omodeos, hartoi një plan pune për tharjen e kënetës së Maliqit, pa një studim paraprak mbi planin e Omodeos. Koha tregoi se një studim mbi projektin kishte qenë shumë i nevojshëm.

Më 29 mars 1955, Qeveria Amerikane paraqiti në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, në sesionin e Këshillit Ekonomik e Shoqëror, raportin me objekt “Evidenca e ekzistencës të punës së detyruar në Shqipëri”, ku flitet mbi punën e detyrueshme ose punën me “përdhunë” (siç edhe e cilëson raporti i qeverisë amerikane), bërë nga të burgosurit politikë shqiptarë në “kampet e vdekjes” (citim i raportit).

“Qeveria shqiptare nuk bën asnjë tentativë për të fshehur faktin se ajo kërkon punë të detyruar nga persona kundërshtarë politikë dhe “dembelë”, shumica e të cilëve janë nga klasa ish-borgjeze ose pronarë tokash.” citon raporti i Qeverisë Amerikane në sesionin e OKB-së të 1955.

Raporti amerikan cilëson se “në dekadën e parë të qeverisjes së komunistëve (1944-1954) u ngritën 40 burgje politike dhe kampe koncentrimi, në të cilët kanë kaluar 80 mijë burra, gra e fëmijë nga të cilët, 16 mijë kanë humbur jetën. Në vitin 1954 punojnë 15 mijë të burgosur politikë në kampe koncentrimi, që përfshijnë ndërtim hidrocentralesh, rrugësh, tharje kënetash.”

Ky raport u përcoll me shqetësim nga Ministri i Jashtëm i Republikës Popullore të Shqipërisë, i cili në shkresën dërguar Komitetit Qendror të Partisë së Punës e konsideron “çpifje në lidhje me të ashtuquajturën ‘punë të detyruar’ në vendin tonë”.

Në kuadër të 20 shkurtit, shembjes së shtatores së diktatorit dhe 26 shkurtit, datës kur 22 intelektualë u ekzekutuan pa faj me akuzën e stisur për vënien e bombës në ambasadën sovjetike, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit përuroi dy ekspozita të përhershme informuese në ish-kampin e Tepelenës dhe të Maliqit, me praninë e

familjarëve të viktimave dhe të mbijetuarve, pushtetit lokal, policisë dhe prokurorisë rajonale, shoqatave të kujtesës dhe të përndjekurve, trupit diplomatik, institucioneve arsimore dhe mediave.

Për herë të parë në 30 vjet, në këto vende kujtese që duhet të jenë të vizitueshme nga të rinjtë dhe shkollat, ka informacion mbi dokumente arkivore, dëshmi dhe skica të të mbijetuarve.

 Libri me dëshmitë e familjarëve të personave që ende nuk u dihet vendi i prehjes u prezantua në mjediset e Autoritetit, në gjuhën shqipe dhe angleze. Libri është i dyti në kolanën e dëshmimeve, pas botimit të parë me të mbijetuarit e kampit të Tepelenës.

Sot ka një ekspozitë virtuale në shqip dhe anglisht “Sigurimi në fjalët e veta”, që mund të vizitohet në çdo kohë, nga çdo vend i botës, me informacionet e hulumtuara në 19 historikë të degëve të Sigurimit në rrethe.


Jeta dhe kujtimi i atyre që u dënuan dhe ndëshkuan padrejtësisht nga diktatura, që me breza u konsideruan “armiqtë e popullit” nuk mund të kalojë pa u ndier.

Vizitë e shkollave të Tiranës në Muzeun e Shkencave të Natyrës, “Sabiha Kasimati” për 26 shkurtin 1951

Pas drekës së datës 19 shkurt 1951, u hodh një sasi e vogël dinamiti në oborrin e ndërtesës së ambasadës sovjetike. Pati alarm në Ministrinë e Brendshme dhe në qarqet e larta politike të Tiranës dhe shqetësim në ambasadën sovjetike të Tiranës dhe në Ministrinë e Jashtme të BS-së. Pleniumi i KQ të PPSH i ndërpreu për kohësisht punimet, sepse u mbledh urgjentisht Byroja Politike e KQ të PPSH, që mori në shqyrtim incidentin e rëndë në Ambasadën Sovjetike.

Ministri i Brendshëm kërkoi nga Byroja Politike që arrestimet të bëheshin qysh atë natë, disa qindra persona, pa bërë hetime për ngjarjen dhe pa gjetur provat për personat e pandehur. Ministria e Brendshme dhe Sigurimi i Shtetit përpiluan listën e vdekjes, arrestimin dhe pushkatimin e 22 vetave (nga datat 19-26 shkurt 1951).





Secili prej emrave të përzgjedhur, arrestuar me ngut dhe dënuar kishte një histori të pasur individuale dhe familjare, në fusha të ndryshme dhe përfaqësonte më së miri shtresën intelektuale e properëndimore të Shqipërisë së asaj kohe. Të arrestuarit u pushkatuan pas pesë ditëve, pa prokuror, pa gjyq e pa asnjë shpjegim zyrtar, mesnatën e 26 shkurtit të vitit 1951, pranë Urës së Beshirit. Ky veprim u quajt i përligjur,

sipas një dekreti me gjashtë nene, për „veprimtaritë terroriste” që u hartua me vonesë nga kreu i Ministrisë së Brendshme M. Shehu dhe u miratua rrufeshëm nga Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe Byroja e PPSH, më 26 shkurt 1951, kur gjithçka, pa gjyq, kish marrë fund. Ministri i Drejtësisë nuk mori pjesë në këtë farsë.

Pas ekzekutimit të viktimave që shkuan drejt vdekjes pa e ditur pse, dokumentet gjyqësore u plotësuan me mangësi. Kur viktimat nuk jetonin më, nga një dokument i vonuar gjyqësor, u mor vesh se më datën 27 shkurt 1951, një trup gjyqtarësh fantazmë i përbërë nga tre vetë, pa praninë e prokurorit, kish dhënë vendim për dënimin me vdekje të 22 personave.

Familjet e të ekzekutuarve u përndoqën brutalisht për vite me radhë. Në korrik të vitit 1991 ata kërkuan pafajësinë e familjarëve të pushkatuar pa gjyq. Vendimi i Gjykatës së Lartë i shpalli të pafajshëm 22 intelektualët e dënuar.

Në vitin 1993, të sinjalizuar nga banorë të zonës dhe të orientuar nga dëshmitarë okularë,



familjarët arritën të gjenin vendekzekutimin dhe vendvarrimin e përfolur pranë Urës së Beshirit. Me identifikimin e vendit u krye edhe zhvarrimi i tyre dhe më pas rivarrimi me të gjitha nderimet në varrezat e Dëshmorëve të Kombit.

Presidenti i Republikës ka nderuar me medalje 22 intelektualët e ekzekutuar, po ashtu familjarët e tyre për vlerat dhe dinjitetin njerëzor të treguar në vite.

Në 2018, me propozim të Autoritetit, Muzeu i shkencave të Natyrës në Tiranë, i ideuar nga Sabiha Kasimati, mori emrin e shkencëtares së ihtiologjisë. Po këtë vit, këndi i kujtesës Sabiha Kasimati u vendos në hyrje të Muzeut, i punuar nga AIDSSH, në bashkëpunim me biologë, historianë, studiues, familjarë, gazetarë e dizajner, jep informacion për shkencëtaren, puna dhe jeta e së cilës u ndërpre dhunshëm mesnatën e 26 shkurtit 1951.

Vepra e saj shkencore "Peshqit e Shqipërisë" me studime të qenësishme në terren, ende sot është pronësi intelektuale e munguar, e mohuar.



Një vit më pas, më 26 shkurt 2019, me propozim të Autoritetit, rruga që të çon në vendekzekutimin e intelektualëve në Mënik, mori emrin “26 shkurti”.

*Në foto nxënës të shkollës Jeronim de Rada, të cilët u njohën me Këndin e Kujtesës "Sabiha Kasimati" nga studiuesja Dr. Ani Bajram

